



VENDIM

Nr. 150 Datë 07.12.2011

PËR

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË LICENSUARIT PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET EKZISTUESE
ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Vendimit nr. 5, datë 26.01.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për periudhën e tretë rregullatore,

Vendosi :

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012, do të jetë 7.77 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e te licensuarve dhe te KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI